VENDIM
Nr. 866, datë 27.12.2022

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "SISTEMIM, ASFALTIM E MASA INXHINIERIKE NË KM 21+050-22+050, NË RRUGËN 'QAFËTHANË–LIN–POGRADEC'"

(Ndryshuar me VKM-në nr. 429, datë 26.6.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Sistemim, asfaltim e masa inxhinierike në km 21+050-22+050, në rrugën 'Qafëthanë–Lin–Pogradec'".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall", "arë", kultura bujqësore "drufrutorë" dhe "vresht", me vlerë të përgjithshme prej 10 703 498 (dhjetë milionë e shtatëqind e tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 10 703 498 (dhjetë milionë e shtatëqind e tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale[1], në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Drejtoria e Miradministrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

---

[1] VKM nr. 429, datë 26.6.2024 botuar në Fl.Z nr. 110, date 2.7.2024 Kreun II të tij shprehet: "*II. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.*"

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E SEGMENTIT RRUGOR "SISTEMI ASFALTIM E MASA INXHINIERIKE NË KM 21+050-22+050 NË RRUGËN QAFËTHANË–LIN–POGRADEC"

NR.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	ZONA KADASTR.	NUMRI I PASURISË	SIP. TOTALE (m²)	Lloji i pasurisë	SIP. (m²)	ÇMIMI (LEK/m²)	VLERA (LEK)	Vlera Kultura Drufrutore	Vlera objektet (lek)	Sipërfaqe e objektit (m²)	Vlera totale (lek)	SHËNIME
1	Llazi	Sotir	Lala	8582	20/133	1950	Truall	27	10491	283257				283257	**Konfirmim**
	Astrita	Sotir	Lala												
	Tatjana	Sotir	Adhami												
	Sotiraq	Llazi	Lala												
2	Elvira	Asqeri	Biba	8582	20/160	194	Truall	28	10491	293748				293748	**Konfirmim**
3	Danica	Vasil	Kristic	8582	20/161	72.5	Truall	9	10491	94419				94419	**Konfirmim**
	Jovan	Vasil	Kristic												
4	Danica	Vasil	Kristic	8582	20/162	183.5	Truall	18	10491	188838				188838	**Konfirmim**
	Jovan	Vasil	Kristic												
5	Bardhyl	Ahmet	Mukollari	8582	20/165	605	Truall	45	10491	472095				472095	**Konfirmim**
	Flamur	Rexhep	Mukollari												
6	Agim	Ritvan	Malellari	8582	20/135	1120	Are	61	192	11712				11712	**Konfirmim**
	Sokol	Ritvan	Malellari												
7	Viktori	Pando	Ziko	8582	20/58	1915	Truall	197	10491	2066727				2066727	**Mbi këtë truall ka 1 ndërtim të paligjshëm**
	Eftim	Llazi	Ziko												
	Agathi	Llazi	Ziko												
8	Bashkëpronarët Todolli,Vesho,Ambo,Dulja			8582	20/147	1690	Are	609	192	116928	327200			444128	**Konfirmim**
9	Bashkëpronarët Todolli,Vesho,Dule			8582	20/113	98	Truall	35	10491	367185		380393	34	747578	**Konfirmim**
10	Bashkëpronarët Todolli,Vesho,Dule			8582	20/116	250	Truall	250	10491	2622750		447172	65	3069922	**Konfirmim**
11	Llambi	Kristaq	Troçi	8582	20/166	1440	Are	191	192	36672				36672	**Konfirmim**
12	Renard	Hekuran	Haxhillari	8582	20/91	310	Truall	262	10491	2748642				2748642	**Konfirmim**
13	Shtet			8582	20/105	1324	Are	660	192	0	0			0	**Konfirmim**
14	Bashkëpronarët Malellari			8582	20/167	568	Are	137	192	26304				26304	**Konfirmim**
15	Mikail	Xhafer	Goca	3665	185/2	500	Are	103	192	19776				19776	**Konfirmim**
		SHUMA						**2632**		**9349053**	**327200**	**827565**	**99**	**10503818**	

ÇMIMET PËR LLOJIN E PASURISË JANË MARRË BAZUAR NË VKM-në NR. 89 DATË 3.2.2016, "PËR MIRATIMIN E HARTËS SË VLERËS SË TOKËS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË".

(Shtuar me VKM-në nr. 429, datë 26.6.2024)

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 866, DATË 27.12.2022, 'PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'SISTEMIM, ASFALTIM E MASA INXHINIERIKE NË KM 21+050-22+050, NË RRUGËN QAFËTHANË–LIN–POGRADEC""

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Të dhënat kadastrale	Vlerësimi për shpronësim	Vlera kultura	Vlera e objektit	Sipërfaqja e	Vlera totale	Shënime

				Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sip. totale m^2	Lloji i pasurisë				drufrutore	(lekë)	objektit (m^2)	(lekë)	
								Sipërfaqja e shpronësuar m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera (lekë)					
16	Vangjo	Jovan	Gjika	8582	20/105	1,270.00	Vresht	655	192	125,760.00				125,760.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
17	Aleks	Kajo	Topalli	8582	20/171	500.00	Arë	385	192	73,920.00				73,920.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Vlera totale							1040		199,680.00				199,680.00	